




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 5 të Rregullores për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësor për fëmijët, 15Nr.011-28044 e datës 02.05.2018, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR THEMELIMIN E MEKANIZMIT KOORDINUES KOMUNAL PËR MBROJTJEN DHE
REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim themelohet Mekanizmi Koordinues Komunal për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve, në përbërje:

1. Vlora Limani Hajnuni, Drejtoreshë e DSHPS, kryesuese
2. Gjyste Dabaj, Koordinatore e NJDNJ dhe barazi gjinore, anëtare
3. Makfirete Shamolli, Drejtoreshë në QPS, anëtare
4. Lorik Bërbatovci, Zyrtar në QPS, anëtar
5. Behar Amerllahu, Tryeza multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve, anëtar
6. Agim Krasniqi, Drejtor i QKMF në Lipjan, anëtar
7. Burbuqe Dervisholli, SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan, anëtare
8. Brahim Duriqi, Zyrtar në Drejtoratin për Arsimit, anëtar
9. Radmila Simijonoviç, Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete, anëtare
10. Selman Jashanica, Zyrtar në DKRS, anëtar
11. Valon Sylejmani, Klubet sportive, anëtar
12. Valmira Marevci, OJQ – Lipjan Youth Center (LYC), anëtare
13. Fitim Sadiku, OJQ - Polis, anëtar
14. Një përfaqësues nga, Institucioni i Avokatit të popullit, në cilësinë e vëzhguesit
15. Xhevahire Salihu, Policia e Kosovës, anëtare
16. Hajdin Rexhepi, Gjykata Themelore Prishtinë – Dega në Lipjan, anëtar
18. Një përfaqësues nga, Prokuroria Themelore Prishtinë, anëtar
19. Abaz Buja, Shërbimi Korrektues i Kosovës, anëtar
20. Minire Avdiu, Shërbimi Sprovues i Kosovës, anëtare
21. Idriz Sopa, Këshillat e fshatrave dhe lagjeve urbane, anëtar
22. Hamide Sopa, Shoqatat profesionale, anëtare
23. Milazim Sadiku, Kryetar i Këshillit të Prindërve, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Mekanizmit koordinues

1. Në pajtim me dispozitat e Rregullorës, Mekanizmi Koordinues kryen detyrat si në vijim:
 - 1.1. Promovoj konceptin e komunës mike për fëmijë dhe praktikën e përkufizuar sipas mjeteve dhe udhëzimeve të krijuara;

- 1.2. Sigurojë koordinimin e politikave të cilat ndikojnë tek fëmijët;
- 1.3. Sigurojë që aktet ligjore të nivelit lokal të i promovojnë dhe i mbrojnë të drejtat e fëmijëve;
- 1.4. Kryen vetëvlerësime periodike të cilat rezultojnë me veprime dhe politika që duhet të ndërmerren nga institucionet komunale në mënyrë që të krijohet një komunë mike për fëmijë;
- 1.5. Udhëheqë procesin e hartimit të strategjisë komunale dhe planit të veprimit për fëmijë në baza periodike dhe të përcjellë zbatimin e tij bazuar në vetëvlerësimin komunal;
- 1.6. Strategjia komunale dhe plani i veprimit për të drejtat e fëmijëve miratohen në Kuvendin Komunal;
- 1.7. Sigurojë një sistem komunikimi që mundëson rrjedhën dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve komunale dhe njësive specifike të institucioneve relevante, përgjegjëse për çështjet e fëmijëve;
- 1.8. Bënë rekomandime për të vepruar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve;
- 1.9. Bënë rekomandime për fëmijët në lëvizje apo fëmijëve në qendrën për azil.

2. Mekanizmi koordinues nuk e përjashton krijimin e organeve, ekipeve dhe trupave të tjerë, në vartësi të këtij mekanizmi, qofshin ato të përkohshme apo të përhershme, të orientuara në aspekte të veçanta të të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, kjo e fundit duhet t'i mbajë marrëdhëniet me organet e krijuara, të raportojë mbi punën e tyre dhe të marrë këshilla dhe rekomandime nga mekanizmi koordinues.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Mekanizmit koordinues.

INr. 550-7363 /
Lipjan, më 10.12.2018

KRYETARI I KOMUNES
Imri Ahmeti

